




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN



VENDIM

Nr.3, datë 30/06/2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
NËNTOKËSOR PËR UJË TË AMBALAZHUAR SUBJEKTIT
“BUKANIKU” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar subjektit “Bukaniku” me adresë Fshati Derstilë, Njësia Administrative Gjinar, Bashkia Elbasan Qarku Elbasan, në akuiferin Destilë, në burimin ujor “Burimi i Bushit”.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor “Burimi i Bushit”

- X= 516550; Y= 4546019; Z=1029 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja e ujit të kërkuar: 3 l/s
- Prurja llogaritëse: 3 l/s
- Prurja mesatare vjetore: 4 l/s
- Mënyra e Kaptazhit do të jetë me vepër marrje pusët betoni me filter zhavorri

Vendndodhja e pikës ku do të shfrytëzohet uji:

- X= 516003; Y= 4545606; Z=825 m.m.n.d. (KRGJSH)



Vendndodhja e pikës së shkarkimit

- X= 516524; Y= 4546017; Z=1015 m.m.n.d. (KRGJSH)

3. Zbatimi i lejes nuk duhet të pengojë rrjedhën ekologjike.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

